



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE  
KRYETARI

Nr. 527/1 prot.

Tiranë, më 18/04/2024

**Lënda:** *Përcillen Vendimet e KIZ*

**DEKANIT TË FAKULTETIT TË MUZIKËS**  
**Prof. Dr. Isak SHEHU**

**DEKANIT TË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA**  
**Prof. Artan PEQINI**

**DEKANIT TË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK**  
**Prof. Ilir MARTINI**

*Të nderuar,*

Bashkëngjitur përcillen për njohje dhe zbatim:

1. Vendimi nr. 3, datë 18.04.2024 “Për zgjedhjen e anëtarëve të KZF-ve në Fakultetet e Universitetit të Arteve”.
2. Vendimi nr. 4, datë 18.04.2024 “Për shpalljen e ditës së filimit dhe përfundimit të procesit të regjistrimit të kandidaturave për Rektor dhe për anëtar të Senatit Akademik, në Universitetin e Arteve”.

Në kuadër të mundësisimit të një procesi të rregullt, lutem në marrjen e masave që njoftimi të afishohet në ambiente të dukshme të secilit fakultet apo në këndet zgjedhore.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KRYETARI**

**Orges MALAJ**



Nr. 528 prot.

Tiranë, më 18/04/2024

VENDIM

Nr. 4, Datë 18/04/2024

**“PËR SHPALLJEN E DITËS SË FILLIMIT DHE PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATURAVE PËR REKTOR DHE PËR ANËTAR TË SENATIT AKADEMIK, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të Urdhrit nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Arteve”, miratuar me VSA nr. 17, datë 29.03.2024, Komisioni Institucional Zgjedhor,

VENDOSI:

1. Shpalljes e ditës për fillimin dhe përfundimin e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Rektor dhe anëtarë të Senatit Akademik të UART, nga rradhët e stafit akademik dhe të studentëve.
2. Regjistrimi i kandidatëve do të kryhet pranë Sekretarisë së KIZ, nga dita e hënë, dt. 22.04.2024 deri ditën e premte, dt. 26.04.2024, deri në ora 16:00.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare elektronike të UART si dhe të afishohet në këndet zgjedhore.

KRYETAR

Z. Orges Malaj

Znj. Suela Agolli

Z. Shpëtim Kërçova

Znj. Adela Kusuri

Znj. Sara Caca

SEKRETAR

Z. Redjan Mulla